

Festivali polip
15-17 maj, 2025, Prishtinë

DHE PRAPË DIELLI LIND
Artikulimi kreativ i rezistencave nëpër histori e gjeografi, përtej mureve.

Qendra Multimedia në bashkëpunim me Molla e Kuqe

PROGRAMI

15 maj

19:30 - 20:00 | TEATRI ODA

Hapja zyrtare e festivalit

**E hapur për publikun. Në anglisht dhe shqip.*

20:00 - 21:30 | TEATRI ODA

Shfaqje teatrore: Hija e Gjatë e Alois Brunner

Nga: Mudar Alhaggi, Regjia: Omar Elerian

Aktorë: Wael Kadour, Mudar Alhaggi, Mohamad Al Rashi

**E hapur për publikun. Në arabisht me përkthim në anglisht dhe shqip.*

16 maj

17:00 - 18:30 | BURG U IDEALIT (Shëtitorja II)

Diskutim: E Kaluara që përndjek të ardhmen: Artikulim kreativ i momenteve historike

Me: Mudar Alhaggi, Wael Kadour, Mohamad Al Rashi

Moderator: Alban Beqiraj

**E hapur për publikun. Në anglisht.*

19:00 - 21:00 | KINO ARMATA

Shfaqje filmi: LETRA TË HAPURA

Regjia: Katharine Domonicé

**Pas shfaqjes do të ketë një sesion pyetje-përgjigje me regjisoren dhe protagonistët.*

**E hapur për publikun. Në anglisht dhe shqip.*

17 maj

16:00 - 17:30 | BURGU I IDEALIT (Shëtitorja II)

Diskutim: Sindroma e (jo)karakterit kryesor? Përfaqësimi i grave në letërsinë e Ballkanit

Me: Ivana Trajanoska, Robert Alagjovovski, Blerina Gaxha Rogova

Moderatore: Aulonë Kadriu

**E hapur për publikun. Në anglisht.*

18:00 - 19:00 | BURGU I IDEALIT (Në qeli)

Lexim: Tregime të ish-të burgosurve/ave politikë/e nga Kosova

Aktorë: Shpëtim Selmani, Adrian Morina, Semira Latifi

**E hapur për publikun. Në shqip.*

20:00 - 21:30 | BURGU I IDEALIT (Shëtitorja I)

Shfaqje teatrale: Bëje ose Vdis

Nga: Jeton Neziraj; Regjia: Blerta Neziraj

Aktorë: Jahja Shehu, Ernest Malazogu, Albulena Kryeziu Bokshi, Edi Kastrati, Altina Kusari, Armend Smajli

**E hapur për publikun. Në shqip.*

Program plotësues në Burgun e Idealit

18 Maj

20:00 - 21:30 | BURGU I IDEALIT (Shëtitorja I)

Shfaqje teatrale: Bëje ose Vdis

Nga: Jeton Neziraj; Regjia: Blerta Neziraj

Aktorë: Jahja Shehu, Ernest Malazogu, Albulena Kryeziu Bokshi, Edi Kastrati, Altina Kusari, Armend Smajli

**E hapur për publikun. Në shqip.*

DETAJET E PROGRAMIT

SHFAQJE TEATRORE

HIJA E GJATË E ALOIS BRUNNER

Prodhuar nga: Collective Ma'louba në bashkëpunim me euro-scene Leipzig, Factory International dhe Theater an der Ruhr.

15 Maj @ 20:00 | TEATRI ODA

Nga: Mudar Alhaggi // Regjia: Omar Elerian // Aktorët: Wael Kadour & Mohamad Al Rashi // Dizajni: Jonas Vogt // Këshillë dramaturgjike dhe hulumtim: Eric Altorfer // Producent Ndërkombëtar: Eckhard Thiemann

"Hija e Gjatë e Alois Brunner" eksploron historinë e vërtetë të një prej kriminelëve nazistë më të kërkuar që i shpëtoi dënimit. Instrumental në deportimin e mbi 100,000 personave në kampe të përqendrimit dhe geto, Alois Brunner i shpëtoi disa tentimeve për arrestim – duke ikur në Damask ku ndihmoi në ndërtimin e shërbimeve të inteligjencës siriane. Duke mbërritur në Berlinin e shekullit XXI si refugjat, dramaturgu sirian Mudar Alhaggi zbulon historinë e Brunnerit dhe fillon ta hulumtojë me obsesion, para se të zhduket vetë...

Në këtë shfaqje të fuqishme, takohemi me dy aktorë që bashkojnë fragmentet e hulumtimit të Alhaggi-t, teksa përjetimi personal, historia botërore, e vërteta dhe trillimi ndeshen. Duke endur historinë siriane dhe gjermane, "Hija e Gjatë e Alois Brunner" eksploron ekzilin, llogaridhënien dhe kujtesën politike – dhe fijet komplekse që lidhin të kaluarën me të tashmen.

Shfaqja shtron pyetje të thella rreth strehimit, drejtësisë dhe shpresës.

"...një mister i tensionuar i shkrimtarit të zhdukur dhe të arratisurit nazist... intriguese, komplekse dhe plot nuanca..." **The Guardian**

"Një vepër tërheqëse teatrore që do të më mbetet në mend për kohë të gjatë, ndoshta përgjithmonë." **Theatre Reviews North**

"Shfaqje e suksesshme që krijon empati dhe na afron me përvojat e të tjerëve."

Leipziger Volkszeitung

SHFAQJE E FILMIT DOKUMENTAR LETRA TË HAPURA

16 Maj @ 19:00 | KINO ARMATA

Skenariste & Regjisore: Katharine Dominicé // Producentë: Katharine Dominicé & Damien Molineaux // Protagonistë: Merita, Vlora, Saime dhe Kadri Avdullahi, Olga Esperante, Yannick Gilestro, Jesus Gomez, Helena Verissimo de Freitas // Teksti i narracionit: Antoine Jaccoud. Një prodhim i Earthling dhe Gena John and the Kids.

Midis viteve 1934 dhe 2002, Zvicra lëshoi rreth gjashtë milionë leje qëndrimi sezonale, të njohura si leje "A", për punëtorët imigrantë. Ky status ishte krijuar ekskluzivisht për të përmbushur nevojat e rritjes së vendit dhe u impononte përfituesve rregulla shumë të rrepta. Punëtorëve sezonalë nuk u lejohej të sillnin familjet e tyre dhe qëndrimi i tyre në Zvicër kufizohej në 9 muaj në vit. Fenomeni i "fëmijëve të dollapit", i njohur kështu sepse fëmijët duhej fshehur, ishte një nga pasojat më të mëdha të kësaj politike.

Në një seri letrash të hapura, ish-punëtorët sezonalë dhe fëmijët e tyre rrëfejnë ndikimin që këto ndarje të vazhdueshme patën në jetën e tyre. Ky ndikim mbetet i prekshëm edhe sot dhe zbulimi i tij vë në pikëpyetje indiferencën e çuditshme që zvicranët kishin ndaj këtyre qenieve njerëzore – nga Italia, Spanja, Portugalia dhe ish-Jugosllavia – të destinuar për të rindërtuar një vend të huaj për ta, ndërkohë që prej tyre pritej të mbeteshin të padukshëm.

SHFAQJE TEATRORE

BËJE OSE VDIS

Prodhuar nga Teatri "Hadi Shehu" Gjakovë

17 & 18 maj @ 20:00 | BURGU I IDEALIT

Nga: Jeton Neziraj // Regjia: Blerta Neziraj // Aktorë: Jahja Shehu, Ernest Malazogu, Albulena Kryeziu Bokshi, Edi Kastrati, Altina Kusari, Armend Smajli // Koreograf: Gjergj Prevazi // Kompozitor: Trimor Dhomi // Skenografë: Petrit Bakalli & Alice Vanini // Kostumografe: Iliriana Loxha Basha

"Bëje ose vdis" është një shfaqje-homazh për politikanin, intelektualin dhe profesorin e njohur shqiptar Ukshin Hoti, ish i burgosur politik në burgjet jugosllave e serbe. Ai ishte burgosur disa herë, për herë të parë në vitin 1981 e së fundmi në vitin 1994. Zyrtarisht ngelet njëri prej mbi 1,500 të zhdukurve nga lufta e vitit 1998-1999 në Kosovë, trupat e të cilëve akoma nuk janë gjetur. Megjithatë, indikacionet çojnë te faktet që autoritetet serbe të burgut të Dubravës, ku Ukshin Hoti ka qenë i burgosur bashkë me qindra të burgosur të tjerë shqiptarë, e kanë liruar në maj të vitit 1999, e pastaj e kanë pushkatuar jo shumë larg dyerve të burgut.

Ukshin Hoti sot është kthyer në një simbol që sublimon fatin tragjik të atyre dhjetra mijëra të burgosurve politikë shqiptarë, të vrarë e të torturuar burgjeve jugosllave e serbe. Por ai është poashtu edhe emblemë që përfaqëson përpjekjen, përkushtimin,

sakrificën e angazhimit politik për liri, barazi e dinjitet të popullit shqiptar, të atyre dhjetra e mijëra grave e burrave aktivistë të ilegales shqiptare në Kosovë. Rezistenca, qëndresa dhe çmimi i lartë që ky brez idealistësh kanë paguar në burgje, me krejt dritë-hijet, është themeli mbi të cilin ngritet Republika e Kosovës, por është edhe frymëzim për brezat që tani po rriten pa frikën se dikush mund t'i burgosë vetëm pse janë shqiptar.

"Drama dokumentare 'Bëje ose vdis' është bazuar në shkrimet e Ukshin Hotit si dhe në dokumentet dhe materialet arkivore për dhe rreth aktivitetit të tij politik e shoqëror. Material i rëndësishëm për shkrimin e dramës ka qenë rrëfimi për periudhën në burg me Ukshin Hotin i Bajrush Xhemajlit, edhe ky ish i burgosur politik. Poashtu, janë intervistuar edhe Pal Shtufi, Bajram Gashi, Lumnije Azemi- Morina, Bajrush Xhemajli, Basri Musmurati, Salihe Salihu e Halil (Sulejman) Selimi, e copëza nga këto intervista janë përdorur në shfaqje. Njerëz të tjerë që kanë dhënë kontributet e tyre për shkrimin e kësaj drame janë edhe shkrimtari Azem Deliu, që ka realizuar intervistat dhe aktori Bajrush Mjaku, që në fakt, ka qenë nxitësi kryesor që kjo dramë të shkruhet, për çka edhe e falenderoj". **(Jeton Neziraj, autor i dramës).**

DISKUTIM

E KALUARA QË PËRNDJEK TË ARDHMEN: ARTIKULIM KREATIV I MOMENTEVE HISTORIKE

16 Maj @ 17:00 | BURGU I IDEALIT (Shëtitörja II)

Folës: Mudar Alhaggi, Wael Kadour, Mohamad Al Rashi

Moderator: Alban Beqiraj

Si e mbajmë peshën e historive të pazgjidhura? Dhe si përballemi artistikisht me fantazmat e padrejtësisë që ende formësojnë të tashmen? Ky panel bashkon artistët sirianë Mudar Alhaggi, Wael Kadour dhe Mohamad Al Rashi — krijues të shfaqjes Hija e Gjatë e Alois Brunner, një vepër që trajton çështje si kujtesa, mërgimi dhe përgjegjësia. Ata eksplorojnë sesi arti mund të rikthejë rrëfimet e heshtura nga regjimet, dhe sesi tregimet nga gjeografi të ndryshme mund të ndërthuren mes vete.

Diskutimi do të trajtojë gjithashtu edhe teatrin në Siri, në dritën e rënies së diktaturës atje, si dhe rrugët që artistët sirianë kanë gjetur për të ushtruar artin e tyre në këto rrethana të vështira, dhe se si ata e shohin

DISKUTIM

SINDROMA E KARAKTERIT (JO)KRYESOR: PËRFAQËSIMI I GRAVE NË LETËRSINË E BALLKANIT

17 Maj @ 16:00 | BURGU I IDEALIT (Shëtitorja II)

Folës/e: Ivana Trajanoska, Robert Alagjovovski, Blerina Gaxha Rogova
Moderatore: Aulonë Kadriu

Si paraqiten gratë në letërsinë ballkanike — dhe çfarë na tregon kjo paraqitje për shoqëritë tona në përgjithësi? Shpeshherë, gratë shfaqen si muze, viktima ose metafora, dhe jo si personazhe të plota, komplekse, me agjenci dhe zë të vetin. Ky panel shqyrton dinamikat gjinore në tregimtarinë e rajonit, duke eksploruar se si letërsia ka pasqyruar, forcuar ose sfiduar normat patriarkale.

Kush i rrëfen historitë — dhe kush mbetet në margjinë? Por më e rëndësishmja, pse ndodh kjo? Paneli gjithashtu trajton pozitën e grave si autore në Ballkan, ku njohja letrare, mundësitë e botimit dhe mbështetja institucionale mbeten ende thellësisht të pabarabarta.

Cilat barriera vazhdojnë të kufizojnë pjesëmarrjen dhe dukshmërinë e grave në letërsi? Dhe si mund të shërbejë letërsia si hapësirë për të rimenduar rolet gjinore dhe për të rimarrë fuqinë rrëfimtare?

Si mund letërsia të sfidojë narrativat e trashëguara dhe të krijojë hapësirë për paraqitje më të nuancuara, më të fuqishme dhe më komplekse të grave dhe përvojave të tyre? A mund të shkëputet ajo nga barra tradicionale dhe historike që është e ngulitur thellë në mënyrën e saj të funksionimit dhe të fillojë të vendosë në qendër zërat që shumë shpesh janë shkruar si personazhe periferike në historitë e veta?

LEXIM

TREGIME TË ISH-TË BURGOSURVE/AVE POLITIKË/E NGA KOSOVA

17 Maj @ 18:00 | BURGU I IDEALIT (Në qeli)

Aktorë: Adrian Morina, Shpëtim Selmani, Semira Latifi

Në prag të shfaqjes "Bëje ose Vdis", në ambientin intim të Muzeut Burgu i Idealit, aktorët Shpëtim Selmani, Adrian Morina dhe Semira Latifi do të japin zë tregimeve të ish-të burgosurve/ave politikë/e nga Kosova, duke përfshirë dëshmitë nga Goli Otoku të botuara nga Integra në librin "Hije të Shtrembëruara", si dhe tregimet e Shukrije Gashit dhe Hava Shalës, të mbledhura nga arkivi digjital i hapur i Inicativës për Histori Goore të Kosovës (Kosovo Oral History Initiative).

Ky aktivitet do të zhvillohet në formatin "një-ndalesë", ku publiku do të ketë mundësinë të lëvizë lirshëm midis qelive dhe tregimeve.